



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data 05.06.2018	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104/02-17963	-1.



KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK
Municipality of Kaçanik

Në mbështetje të vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01-Nr. 104/02-9212/18 të datës 30/03/2018 për formimin e Komisionit për Ndryshim-Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut, në bazë të detyrave dhe përgjegjësive që ka ky komision, propozohet ky:

DRAFT PROPOZIM
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNES SË
KAÇANIKUT TË DATËS 25/09/2008
(PËR SHQYRTIM FILLESTAR)

Kaçanik, maj 2018.

Neni 1

Me këtë draft propozim, ndryshohet dhe plotësohet Statuti i Komunës së Kaçanikut i datës 25.09.2008.

Neni 2

Plotësohet neni 7 me piken 3 me këtë tekst: "Përmbajtja, përdorimi dhe ndryshimi i emblemës dhe simboleve do të përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës në pajtim me Ligjin".

Neni 3

Ndryshohet neni 8 me këtë tekst: "Komuna e ka vulën e vet, të rrumbullaket dhe katrore të formateve standarde. Mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës".

Neni 4

Plotësohet neni 10; hiqet "Komuna" dhe zëvendësohet me "Kuvendi i Komunës dhe Kryetari".

Neni 5

Plotësohet neni 11 me këtë tekst; "Kuvendi i Komunës për kontribut të veçantë në zhvillimin e Komunës mundë të shpallë qytetarë nderi të Komunës se Kaçanikut personalitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit".

Neni 6

Plotësohet neni 13 me këtë tekst; "Territori i Komunës është përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave".

Neni 7

Ndryshohet neni 14 me këtë tekst; "Kufijtë e Komunës mund të ndryshohen me vendimin e pushtetit qendror , pas marrjes së pëlqimit paraprak Kuvendit të Komunës".

Neni 8

Ndryshohet neni 15; në të gjitha pikat e këtij neni ku figuron teksti "zyret e vendit" zëvendësohet me "zyret e gjendjes civile".

Neni 9

Ndryshohet neni 16 me këtë tekst; "Në zyret e Gjendjes Civile sipas nenit 15.2 të këtij statuti do të kryhen të gjitha shërbimet e parapara për zyrën e gjendjes civile, nëse me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë nuk është paraparë ndryshe.

Komuna, sipas nevojës së qytetarëve me vendim të veçantë mundë të delegoj edhe kompetenca të tjera këtyre zyrave.

Komuna, për të bashkëpunuar me fshatrat dhe vendbanimet me rregullore të veçantë të kuvendit të komunës mundë të përcaktojnë formën e bashkëpunimit, strukturën organizative dhe funksionale, mënyrën, kohën dhe çështjet tjera që lidhen me zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane”.

Neni 10

Plotësohet neni 17.2 me këtë tekst; “Komuna gjithashtu duhet të sigurojë që qytetarët kanë pasur mundësi ta shprehin mendimin e tyre paraprakisht se interesat dhe kërkesat e tyre janë marrë në shqyrtim”.

Neni 11

Plotësohet dhe ndryshohet neni 18 me këtë tekst; “Komuna mund të shfrytëzojë secilën nga format e konsultimit të shënuar më poshtë si dhe forma të tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave.

1. Fushatat informuese dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale,
2. Kontakte me grupet e interesit për të testuar dhe diskutuar politikatat në fusha të caktuara,
3. Anketat për implementimin e politikave përfshirë qytetar dhe grupe të interesit.
4. Shpalljet publike, nëpërmjet të cilave bëhet njoftimi për pjesëmarrje në tubime prezantuese të hartimit të politikave dhe draft-rregulloreve.
5. Kontakte me grupet e interesit
6. Komitetet këshillëdhënëse të qytetarëve
7. Takimet publike,
8. Dëgjimet publike,
9. Studimet për vlerësim të efektit dhe
10. Peticionet”.

Neni 12

Ndryshohet neni 21; pika 1 e këtij neni fjalia “grupet fokusuese, konsultuese” zëvendësohet me fjalinë “grupet e interesit”. Pika 2 hiqet e tëra.

Neni 13

Plotësohet dhe ndryshohet neni 22 me këtë tekst; “Komuna duhet të sigurojë publicitetin e duhur dhe duhet t’i shfrytëzoj kanalet dhe mjetet tjera të komunikimit, në mënyrë që t’i përmbush synimet e audiencës. Konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës”.

Neni 14

Ndryshohet neni 23 me këtë tekst; "Komuna brenda afatit 30 ditësh nga dita e mbajtjes së konsultimit me publikun, është e obliguar që t'ju jap përgjigje me shkrim kërkesave dhe sugjerimeve të qytetareve".

Neni 15

Plotësohet neni 26; afati "dy javë" zëvendësohet me "katërmbëdhjetë (14) ditë".

Neni 16

Ndryshohet neni 34 pika 1 me këtë tekst; "Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë i cili ushtron funksionin përfaqësues dhe vendimmarrës në pajtim me ligjet dhe këtë Statut".

Neni 17

Plotësohet neni 35, shtohet pika 2 me këtë tekst: "Procedurat e zgjedhjes së Kryesuesit përcaktohen në Ligin për Vetëqeverisjen Lokale".

Neni 18

Ndryshohet neni 38, hiqet komplet pika 2 me këtë tekst: "Numri i anëtarëve të secilit komitet duhet të përcaktohet nga Kuvendi i Komunës".

Neni 19

Ndryshohet neni 39 pika 1 me këtë tekst; "Komitetet e përhershme janë: Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete. Numri i anëtarëve të KPF-së është 7 anëtar dhe i Komitetit për Komunitete 5 deri 7 anëtar. Përbërja e këtyre komiteve duhet të ketë përfaqësim gjinor sipas ligjeve në fuqi".

Neni 20

Ndryshohet neni 44, hiqet pika 3 me këtë tekst; "Numri i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë së paku 5 dhe më së shumti 9 anëtarë".

Neni 21

Plotësohet neni 57; "Ligjit për Vetëqeverisje Lokale" i shtohet edhe "Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal".

Neni 22

Ndryshohet neni 61 pika 2: Teksti "Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim" zëvendësohet me "Drejtoria përkatëse".

Neni 23

Ndryshohet neni 63: Teksti "Drejtorit për Financa dhe Zhvillim" ndahet vetëm me tekstin "Drejtorit të Buxhetit dhe Financave"

Neni 24

Ndryshohen nenet 64, 65, 67, dhe 68 pika 2; Teksti "Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim" do të zëvendësohet me "Drejtori i Buxhetit dhe Financave".

Neni 25

Ndryshohet neni 77, si dhe shtohen pikat në këtë nen me përmbajtjen si në vijim:

1. Çdo drejtori komunale menaxhohet nga drejtori i drejtorisë, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës.
2. Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtorinë e tyre në pajtim me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.
3. Drejtorët i raportojnë rregullisht Kryetarit të Komunës për çështjet që janë në përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë atij informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes".

Neni 26

Ndryshohet dhe plotësohet neni 78: Hiqen përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorisë së administratës së përgjithshme si dhe listohen drejtoritë me këtë tekst si në vijim: "Në kuptim të autorizimeve ligjore nga dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe organogramit komunal, administrata komunale organizohet në drejtori dhe zyre:

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
3. Drejtoria e Arsimit
4. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
5. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
6. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
7. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
8. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
9. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit".

Neni 27

Ndryshohet dhe plotësohet neni 79; hiqen përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe ky nen plotësohet me pikat tjera me tekstin në vijim: "1. Përpos drejtorive Komunale, Kuvendi i Komunës themelon edhe zyret.
2. Themelimin e zyreve e propozon Kryetari dhe miraton Kuvendi i Komunës.

3. Zyret të cilat janë në vartësi me zyrën e kryetarit janë:

- 3.1 Zyra e Personelit
- 3.2 Zyra e Prokurimit
- 3.3 Zyra për Komunitete dhe Kthim
- 3.4 Zyra për Auditim të Brendshëm
- 3.5 Zyra Ligjore,
- 3.6 Zyra e Inspektoratit
- 3.7 Zyra për Barazi Gjinore
- 3.8 Zyra për Integritet Evropian
- 3.9 Zyra e Teknologjisë Informativë
- 3.10 Zyra e Informimit

Neni 28

Ndryshohet dhe plotësohet neni 80; hiqen detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorisë së arsimit dhe kulturës si dhe shtohet teksti si në vijim:

“1. Kuvendi i Komunës, në kuptim të dispozitave të LVL, në raste të nevojshme, mund të themelojë edhe drejtori tjera për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësitë të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi dhe organogramin komunal.

2. Përshkrimin e detyrave, kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe udhëheqësve të zyrave rregullohen me vendim të veçantë, të cilin e nxjerr Kryetari i Komunës në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të Statutit, vendimi duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 29

Ndryshohet dhe plotësohet neni 81; hiqen detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorisë së ekonomisë, financave dhe zhvillimit si dhe plotësohet neni me tekstin si në vijim:
“Konfliktet e Interesit për Drejtorët- pika 1. Të gjithë drejtorët e drejtorive Komunale përjashtohen nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij kanë ndonjë interes personal ose financiar.

2. Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi shfaqen

3. Statuti i Komunës dhe Rregullorja e Punës përfshijnë masat të cilat merren për të përjashtuar drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë ndeshje interesash”.

Neni 30

Hiqen nenet 82, 83, 84 të cilat paraqesin detyrat dhe përgjegjësitë që kanë drejtoritë.

Neni 31

Hiqen nenet 86, 87, 89. Këto përgjegjësi tashmë përcaktohen me Ligj.

Neni 32

Plotësohet neni 93 me këtë tekst: “Me aprovimin e këtij statuti, të gjitha aktet normative do të harmonizohen me ndryshimet e paraqitura në afat prej tre (3) muajsh”.

Neni 33

Të shtohet: “Pas hyrjes në fuqi të Statutit, Kryetari i Komunës është i obliguar që të propozoj Kuvendit Komunal vendimin apo rregulloren lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve si dhe zyrës së inspektoratit në afat prej tridhjetë (30) ditësh.